REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. e-180/7885
Nr. i faq. 3
Data 02/10/2026

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës
Nr. 002/44
Datë: 28.09.2026

Në mbështetje të nenit 12 dhe nenit 17 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dispozitave përkatëse të Statutit në fuqi të Komunës së Junikut, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e vetëqeverisjes lokale,,Kuvendi Komunal në Junik në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 28.09.2026, mori këtë:

V E N D I M

për inicimin e procedurave për hartimin e Statutit të ri të Komunës së Junikut dhe themelimin e Komisionit për hartimin e tijë

I

Qëllimi

Me këtë Vendim **iniciohen procedurat për hartimin e Statutit të ri të Komunës së Junikut**, me qëllim të harmonizimit të tij me legjislacionin në fuqi dhe përshtatjes së dispozitave statutare me nevojat dhe zhvillimin aktual të Komunës.

II

Inicimi i procedurave

1. Kuvendi i Komunës së Junikut autorizon fillimin e procedurave për hartimin e Statutit të ri të Komunës.
2. Hartimi i Statutit bëhet në mënyrë transparente, gjithëpërfshirëse dhe në pajtim me parimet e ligjshmërisë, pjesëmarrjes qytetare dhe interesit publik.
3. Gjatë hartimit të Statutit duhet të merren parasysh:
   - Ligji për Vetëqeverisjen Lokale;
   - legjislacioni tjetër në fuqi që rregullon vetëqeverisjen lokale;
   - aktet nënligjore relevante;
   - praktikat e mira të qeverisjes lokale;
   - nevojat dhe specifikat e Komunës së Junikut;
   - rekomandimet e institucioneve kompetente dhe të komunitetit lokal.

III

Themelimi i Komisionit

1. Për hartimin e Statutit të ri të Komunës së Junikut themelohet **Komisioni për Hartimin e Statutit të Ri të Komunës së Junikut.**
2. Komisioni përbëhet nga **pesë (5) anëtarë**, si vijon:

Nga Kuvendi i Komunës – tre (3) anëtarë:

1. Shpejtim Gacaferi – anëtar nga subjekti LDK
2. Ajshe Gacaferi – anëtare nga subjekti AAK;
3. Jetmir Tofaj – anëtar nga subjekti VV.

Nga Shoqëria Civile – një (1) anëtar:
4. Florije Shehu – anëtare.

Nga Ekzekutivi i Komunës – një (1) anëtar:
5. Ferdone Tofaj-Gaxherri – anëtare.

IV

Detyrat e Komisionit

Komisioni ka këto detyra:

1. Të analizojë Statutin aktual të Komunës së Junikut dhe të identifikojë dispozitat që kërkojnë ndryshim, plotësim ose riformulim.
2. Të shqyrtojë legjislacionin në fuqi që rregullon organizimin, funksionimin dhe kompetencat e komunave.
3. Të hartojë Draft-Statutin e ri të Komunës së Junikut.
4. Të sigurojë që Draft-Statuti të jetë në pajtim me Kushtetutën, ligjet dhe aktet e tjera në fuqi.
5. Të konsultohet me drejtoritë komunale, këshilltarët komunalë, komunitetin, shoqërinë civile dhe akterë të tjerë relevantë.
6. Të organizojë ose të propozojë organizimin e konsultimeve publike lidhur me Draft-Statutin,
7. Të shqyrtojë komentet dhe propozimet e pranuara gjatë konsultimit publik.
8. Të përgatisë versionin përfundimtar të Draft-Statutit për procedim në Kuvendin e Komunës.

V

Transparenca dhe konsultimi publik

1. Procesi i hartimit të Statutit të ri zhvillohet në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse.
2. Draft-Statuti i nënshtrohet konsultimit publik në pajtim me legjislacionin në fuqi për konsultimin publik.
3. Qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, komuniteti i biznesit dhe palët e tjera të interesuara kanë të drejtë të paraqesin komente, vërejtje dhe propozime.
4. Komisioni shqyrton komentet dhe propozimet e pranuara dhe, sipas vlerësimit të tij, i përfshin në versionin përfundimtar të Draft-Statutit.
5.

VI

Përfundimi i mandatit të Komisionit

Mandati i Komisionit përfundon me përfundimin e procesit të hartimit të Draft-Statutit dhe dorëzimin e tij për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Komunës, përveç nëse Kuvendi vendos ndryshe.

VII

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhen zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL,
- Kryetari i Komunës së Junikut,
- Shërbimi i Kuvendit të Komunes,
- Anëtarët e Komisionit,
- Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit
z.Leonard Lloluni